

Enkelejda Alite
Auditues Ligjore
NIPT L01606037A
Adresa:Rr.Abdi Toptani,Torre Drin,Kati 0, Zyra 19,Tirane
Mob.+355(0)67 2005022
e-mail:enkealite@yahoo.com

KQZ
U PROTOKOLLU
NR. 1123/PROT
DATE 10.06.2019

Drejtuar :Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

Tiranë, datë 10 Qershor 2019

Lenda: Raport i ndërmjetem për rezultatet e monitorimit të fushatës zgjedhore për Organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2019 të subjektit politik "Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë" për periudhën 01 Qershor-09 Qershor 2019

Ju lutem bashkangjitur do të gjeni raportin për rezultatet e monitorimit të fushatës zgjedhore për Organet e Qeverisjes Vendore 2019 të subjektit politik "Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë" për periudhën 01 Qershor-09 Qershor 2019.

Me respekt,


Enkelejda Alite

Eksperte Financiare



Drejtuar :Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

Tiranë, datë 09 Qershor 2019

**Raport i ndërmjetëm për rezultatet e monitorimit të fushatës zgjedhore për Organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2019 të subjektit politik
"Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë"
për periudhën 01 Qershor-09 Qershor 2019**

Unë, Enkelejda Alite, jam emëruar si eksperte financiare për monitorimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore për organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2019 për subjektin politik "Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë "(në vijim e quajtur shkurt "PMDPSH") me vendimin Tuaj Nr.740, datë 31.05.2019 në zbatim të nenit 24/4 të ligjit 8580, datë 17.2.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjin nr.90/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike".

Në vijim po ju paraqes raportin e ndërmjetëm të monitorimit të fushatës zgjedhore të "PMDPSH" për periudhën 01.06.2019-09.06.2019.

Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës Nr.5053 Prot. datë 01.06.2019 dhe vënies në dispozicion nga Ju të informacionit të nevojshëm për kryerjen e shërbimit të monitorimit të fushatës zgjedhore për organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2019, më datë 03.06.2019 mora kontakt me subjektin politik "PMDPSH" dhe përkatësisht me Z. Kadri Isufaj, Kryetar i subjektit zgjedhor "PMDPSH".

Më datë 06.06.2019 në orën 11:30 kam organizuar takim me Z.Kadri Isufaj, të cilin e kam vënë në dijeni për detyrën e ngarkuar nga Ju për monitorimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore të subjektit politik "PMDPSH". Gjithashtu e kam informuar se për realizimine e këtij angazhimi faza e parë do të jetë monitorimi në terren i zyrave elektorale, i materialeve propagandistike,i aktiviteteve dhe veprimtarive të fushatës zgjedhore nga momenti i marrjes së këtij angazhimi deri

Enkelejda Alite
Auditues Ligjore
NIPT L01606037A
Adresa:Rr.Abdi Toptani,Torre Drin,Kati 0, Zyra 19,Tirane
Mob.+355(0)67 2005022
e-mail:enkealite@yahoo.com

në momentin e mbylljes së fushatës zgjedhore datë 30 Qershor 2019. Kjo fazë është shumë e rëndësishme pasi nga gjetjet që do të rezultojnë në terren ne më pas do të bëjmë krahasimin me raportimet financiare që do të bëjnë subjektet zgjedhore në lidhje me fushatën.

Më datë 06.06.2019 kam përgatitur dhe dërguar me postë rekomande shkresat në 61 bashki në të gjithë vendin për të marrë informacion për adresat e sakta të zyrave zgjedhore të subjektit politik "PMDPSH".

Më datë 06.06.2019 kam dërguar në adresën e e-mail-it të Kryetarit të "PMDPSH" Z.Kadri Isufaj dhe me postë rekomande një letër angazhimi për monitorimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore ku përcaktohen si palë angazhuese Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve dhe si palë përgjegjëse subjekti zgjedhor "PMDPSH". Në letrën e angazhimit theksohet se monitorimi do të bëhet bazuar në ligjin Nr.90/2017 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580, date 17.02.2000, "Për Partitë Politike", të ndryshuar, datë 22.05.2017, në Udhëzimin Nr.1 datë 31.05.2017 për "Përdorimin e Materialeve Propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore" dhe Udhëzimin Nr.3, datë 02.06.2017 "Për mënyrën e llogaritjes së kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore."

Gjithashtu subjektit zgjedhor "PMDPSH" i është kërkuar të na vihet në dispozicion informacioni në lidhje me adresat e sakta të zyrave elektorale, listën e aktiviteteve dhe të veprimtarive si dhe materialet propagandistike të përdorura gjatë fushatës zgjedhore për Organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2019 dhe çdo dokumentacion financiar që lidhet me këtë fushatë.

Me respekt,


Enkelejda Alite

